

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

BLERJE BOJE FOSFORESHENTE, BIKOMPONENTE, DYLIENT

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44811000-8

44832000-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

20 831 800 (njëzet milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind) lekë pa tvsh ose,
217 700,91 (dyqind e e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind presje nëntëdhjetë e një) euro.

Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë (kursi kembimit) Bank of Albania, Exchange rate 1 euro=95.69 exchange rate date 20.04.2026

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Ndermarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Për përlogaritjen e fondit limit grupi punës u mbështet në VKM 285 date **19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 76 mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:
 - a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
 - b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
 - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;

ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Mënyra e përzgjedhur ishte sipas pikës a pasi në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës. Çmimet janë referuar manualit të cmimeve të ndertimit ne portalin e - albania.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43 pika 2/b dhe pika 3 te VKM-se nr. 285 dt. 19.05.2021 te ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

Për këtë procedurë prokurimi Njësia e Prokurimit konsideron të arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë.

Duke patur në vëmendje, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së kontrates në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2. *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, bilancet duhet të shoqërohen edhe me raport auditimi ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit*

Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për kontrata të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per kete pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuar.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjithë produktet objekt prokurimi sipas Shtojcës së Specifikimeve Teknike. Ato duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi të kërkuar në ne shtojcën e specifikimeve teknike, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike.

Argumentim: *Në bazë pikës 6/b , të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor mund të kerkoje deshmi qe tregojne se OE pjesemarrës plotesojne kerkesat minimale te percaktuara ne dokumentet e tenderit sic eshte dorezimi i skedave teknike. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues mbi aftësitë teknike.*

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/distributori të autorizuar, ose autorizim prodhuesi/distributori zyrtar për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje deklaratë furnizimi /autorizim nga distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: *Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet gjithashtu me treguesit e cilesise së mallrave e që janë prodhuar në përputhje me standardet.*

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Deklaratë / Çertifikatë Konfirmimit CE të prodhuesit ose raportet e testimi të lëshuara nga laboratore të akredituar, për produktet objekt prokurimi me qëllim përmbushjen e standarteve teknike të kerkuara, sipas Shtojcës së specifikimeve teknike.

Argumentim: *Në bazë të nenit të 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik”, mbi standartet e sigurimit të cilesise ku nder te tjera autoriteti kontraktor mund të kerkoje nga OE pjesemarrës certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimir te konformitetit i akredituar i njoohur ne Republikene Shqiperise si dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.*

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Skeden e Sigurise, për produktet objekt prokurimi, me qëllim transparence per perberjen dhe rreziqet e produktit per mbrojtjen e shendetit te punonjesve dhe menaxhimin e situatave mjedisore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 79 standartet e sigurimit te cilesise dhe standartet e menaxhimit mjedisor, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter perfaqëson nje perdorim me te sigurt te produkteve objekt prokurimi per kete kontrate, konkretisht: informimin mbi rreziqet e mundhsme, udhëzime për përdorim të sigurt, ndihme ne rast emergjence, menxhimin e mbetjeve, perputhshmerine me standartet ligjore.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, mostra të mallit, objekt prokurimi në amballazhim origjinal, nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit.

Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar, në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ndryshuar me [Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”](#) dhe neni 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejt me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Paraqitja e mostrave nga OE, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryeje verifikimet (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik me qëllim vertetimin e perputhshmërisë me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat objekt prokurimi do të jenë te prodhuar jo më herët se 6 (gjashte) muaj nga data e lëvrimit të mallit pranë AK. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se boja do të ketë efektshmëri të lartë gjatë aplikimit me qëllim jetëgjatësine e saj.

SPECIFIKIME TEKNIKE

BOJË AKRILIKE FOSFORESHENTE

Boja të jetë me baze rezine akrilike, e cila do të shërbejë për përdorim të jashtëm, në vijeime rrugësh, parkingje, sheshe sportive, apo në beton etj. Te kete tharje sa më të shpejtë dhe ngjitje shume te forte. Te garantojë shikueshmëri të lartë gjatë natës dhe në kohë me shi, në saj te permbajtjes se sferave te xhamit ne perberjen e saj. Të ketë mbulim të mirë dhe aplikim të lehtë me rrul, furçë dhe pistoletë.

Karakteristikat Teknike:

- Natyra e lidhësit bazë: Rezinë akrilike
- Pësia specifike: 1.7 ± 0.05 kg/litër
- Viskoziteti: 90 ± 10 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
- Norma e hapjes: 1.7 ± 0.05 m²/kg (spesor 0.2 mm)
- Tretesi (solvent): 20 – 25 %
- Tharja: 20-25 min në 25°C
- Permbajtja e bioksid titanit: ≥ 12 % e peshes
- Permbajtja e sferave te xhamit 15 – 33 % e peshes
- Mbetja e thate: > 50 %
- Faktori reflektues: $\beta \geq 0.80$
- Ngjyrat në dispozicion: Sipas kërkesave të AK, sipas katalogut E BARDHE RAL 9003 / E VERDHE RAL 1018
- Magazinimi: Në temperatura në intervalin + 5°C /+ 30°C
- Jetëgjatësia: jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
- Paketimi: Në amballazhe metalike 5-30 kg

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

SSH EN 12802:2011 që ka lidhje me “Materiale për vijëzimet horizontale në rrugë - Metodën laboratorike për identifikime të materialeve të vijëzimit rrugor” ose ekuivalentin e tij si dhe SSH EN 13036-4 që ka lidhje me “Matja e rezistencës ndaj rreshqitjes” ose ekuivalentin e tij.

BOJË BIKOMPONENTE

Boja të jetë me rezine metil metakrilati (*Methyl Methacrylate MMA*), dhe të shërbejë për vijeime rrugësh, parkingje, sheshe sportive etj. Rezina e kësaj boje (komponenti A) në momentin e aplikimit duke u bashkuar me Komponentin B të saj duhet të realizojë një tharje / ngurtësim sa më të shpejtë, për shkak të reaksionit kimik që do të ndodh. Duhet të ketë mbulim të mirë dhe aplikim të lehtë me rrul, dhe furçë.

Karakteristikat Teknike:

- Komponenti A:
- Viskoziteti: 120 ± 20 KU (Krebs-Stormer method) ose ekuivalente
 - Tharja: 10-15 min në 25°C
 - Norma e hapjes: $\leq 1.8 \pm 0.05$ kg/m² (spesor 1mm)

- Pesha specifike:	1.8 ± 0.2 kg/litër
- Faktori reflektues:	$\beta \geq 0.80$
- Ngjyrat në dispozicion:	Sipas kërkesave të AK, sipas katalogut RAL 3001
- Magazinimi:	Në temperatura në intervalin + 5°C/ + 30°C
- Jetëgjatësia:	jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
- Paketimi:	Në amballazh metalike 5-30 kg
Komponenti B:	peroksid dibenzoli 49-52.5 % te peshes
- Pamja:	Puder e bardhe
- Permbajtja e oksigjenit aktiv:	3 - 3.5 % e peshes
- Magazinimi:	jo me shume se 30° C
- Jetëgjatësia:	jo më pak se 1 (një) vit nga lëvrimi
- Raporti i perzierjes A+B:	98% + 2%

STANDARTET TEKNIKE që duhet të përmbushë, si më poshtë vijon:

SSH EN 12802:2011 qe ka lidhje me “*Materiale për vijëzimet horizontale në rrugë - Metodat laboratorike për identifikime e materialeve te vijeimit rrugor*” ose ekuivalentin e tij si dhe SSH EN 13036-4 qe ka lidhje me “*Matja e rezistences ndaj rreshqitjes*” ose EKUIVALENTE.

Argumentimi i specifikimeve teknike: *Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistët e fushës, pjesë e DST.*

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.

Rezinat akrilike sigurojnë rezistencë të lartë ndaj kushteve atmosferike, tharje të shpejtë dhe aderencë të mirë në sipërfaqe si asfalt dhe beton. Kjo i bën ato ideale për aplikime të jashtme si sinjalistika rrugore.

Vlerat e viskozitetit të përcaktuara sigurojnë aplikim të lehtë dhe uniform, duke parandaluar rrjedhjen e tepërt dhe duke garantuar trashësi të qëndrueshme të shtresës.

Koha e tharjes (10–25 minuta) është kritike për rrugët me qarkullim, pasi minimizon kohën e bllokimit dhe rrit sigurinë rrugore.

Ky komponent rrit reflektimin e dritës dhe dukshmërinë, sidomos gjatë natës ose në kushte të dobëta ndriçimi.

Përdorimi i tyre rrit reflektimin retroreflektiv, duke përmirësuar dukshmërinë e vijëzimeve nga dritat e automjeteve.

Vlerat e larta të reflektimit sigurojnë standarde të larta sigurie dhe përputhshmëri me normat europiane.

Kushtet e ruajtjes (+5°C deri +30°C) dhe jetëgjatësia minimale 1 vit garantojnë stabilitetin kimik dhe performancën e produktit.

Sistemet me metil metakrilat ofrojnë rezistencë shumë të lartë mekanike dhe kimike, si dhe jetëgjatësi më të madhe në kushte intensive trafiku.

Përzierja e saktë A+B është thelbësore për aktivizimin e reaksionit kimik dhe arritjen e vetive optimale mekanike.

Specifikimet janë në përputhje me standardet SSH EN 12802 dhe EN 13036, të cilat garantojnë cilësi, rezistencë dhe siguri në përdorim.

Specifikimet e dhëna janë të justifikuara teknikisht dhe sigurojnë performancë të lartë, qëndrueshmëri dhe përputhje me kërkesat e sigurisë rrugore.

Specifikimet teknike justifikojne objektin e kontrates dhe ne to nuk permendet asnje marke prodhimi ose burim specifik qe karakterizon mallrat mallrat e kerkuara.

NJËSIA E PROKURIMIT